



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-135

Prishtinë, më 25 nëntor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 25 NËNTOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Myfera Shinik dhe Goran Marinković.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë të mbajtura më 18 nëntor 2013,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë të mbajtura më 18 nëntor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18 nëntor 2013.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pas shqyrtimit të përgatitjeve të nevojshme për seancën plenare të radhës, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet të enjten, më 5 dhjetor 2013, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimin të ndërtimit të rrugës magjistrale Milloshevë-Mitrovicë-Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID),
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 03//L-102,
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për lojërat e fatit.

Gjithashtu, u konstatua se Kryesia në mbledhjen e saj të radhës mund ta plotësojë këtë rend dite edhe me pika të tjera, që përgatiten në ndërkohë.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. Kërkesa për debat parlamentar, parashtruar nga deputeti Visar Ymeri, mbështetur edhe nga nëntë deputetë të tjerë lidhur me privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës

Kryesia pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që të përgatisë dhe Kuvendit t'ia paraqesë informatën lidhur me privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës, mbi bazën e secilës do të zhvillohet debati parlamentar.

2. Kërkesa për debat parlamentar, parashtruar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga shtatë deputetë të tjerë lidhur me raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi; nënkryetari Sabri Hamiti dhe kryetari i GP të AAK-së Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të përgatisë dhe Kuvendit t'ia paraqesë informatën për të gjeturat dhe sfidat në Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013, mbi bazën e cilës do të zhvillohet debati parlamentar.

3. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për nëntëmujorin e vitit 2013

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, e paraqiti para anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit raportin e shpenzimeve të Kuvendit për nëntëmujorin e vitit 2013.

Kryesia, pasi u informua nga sekretari i Kuvendit për detajet e raportit të shpenzimeve të Kuvendit për nëntëmujorin e vitit 2013, të përgatitur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Administratën e Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2013, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

4. Rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2013

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Autorizohet Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit që të bëjë përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2013.

Pas përzgjedhjes së kompanisë audituese, Drejtoria e Prokurimit duhet ta njoftojë me shkrim Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Pas përfundimit të procedurave, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit për përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2013.

5. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të 15 fshatrave të Rugovës për rishqyrtimin e Ligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Kryesia pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor që ta shqyrtojë kërkesën e banorëve të 15 fshatrave të Rugovës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe në bazë të ligjit dhe Rregullores së Kuvendit të rekomandojë për veprime të mëtejme.

6. Njoftimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, prej 5-8 nëntor 2013

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, të realizuar në Bruksel, prej 5-8 nëntor 2013.

Pikat shtesë:

1. Rekomandimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohen sqarime shtesë nga Organi Përzgjedhës i Pavarur lidhur me veprimet e mëtejme për shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

2. Ftesa e kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama, për pjesëmarrjen e një delegacioni nga Kuvendi i Kosovës në tryezën me temë “Shqiptarët në Evropën e gjeneratës së re”

Për ftesën e kryeministrit diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi; nënkryetari Sabri Hamiti; kryetari i GP të LDK-së, Ismet Beqiri; kryetari i GP të AAK-së, Ardian Gjini; kryetari i GP të PDK-së, Adem Grabovci; kryetari i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me ftesën e lartpërmendur, konstatoi se Kuvendi nuk mund ta marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve për realizimin e kësaj vizite.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale